



Në mbështetje të nenit 26, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe të nenit 11, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datë 14.07.2023, miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2023, PËR PROCEDURËN E
PARASHTRIMIT TË KËRKESAVE PËR LEJIMIN E PËRQENDRIMIT DHE
KRITERET PËR KONSTATIMIN E PËRQENDRIMIT**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurës për paraqitjen e Kërkesës së Përqendrimit, përmbajtjen e kërkesës dhe formën e dokumenteve, si dhe të dhënat që paraqitësi i kërkesës duhet të dorëzojë me formular, përmbajtjen e njoftimit të blerjes së aksioneve, kompanive të sigurimit dhe institucionet e tjera financiare, si dhe kriteret për vlerësimin e përqendrimit në procedurën e kryer nga Autoriteti për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) në bazë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Neni 2
Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për të gjitha përqendrimet të përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, me rastin e parashtrimit të kërkesave për lejimin e përqendrimit dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Në këtë U.A., termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.1. **Kontrolli i vetëm** - një formë kontrolli ku një ndërmarrje e vetme mund të ushtrojë ndikim vendimtar në një ndërmarrje. Mund të dallohen dy situata të përgjithshme të një kontrolli të vetëm. Së pari, ndërmarrja e vetme kontrolluese gëzon fuqinë për të përcaktuar vendimet strategjike tregtare të ndërmarrjes tjetër. Në mënyrë tipike, kjo fuqi arrihet duke fituar shumicën e të drejtave të votës në një ndërmarrje. Së dyti, ekziston një situatë që, gjithashtu paraqet kontroll të vetëm, atëherë kur vetëm një aksionar është në gjendje të vërë

veton ndaj vendimeve strategjike në një ndërmarrje, por që ky aksionar nuk e ka fuqinë, i vetëm, të imponojë vendime të tilla.

1.2. **Kontrolli i përbashkët** - një formë kontrolli ku dy ose më shumë ndërmarrje kanë mundësi të ushtrojnë ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje tjetër. Ndikimi vendimtar në këtë kuptim normalisht nënkupton fuqinë për të bllokuar veprimet që përcaktojnë sjelljen strategjike tregtare të një ndërmarrje.

1.3. **Ndërmarrje e përbashkët** - krijimi i ndërmarrjes së përbashkët nga ndërmarrje të pavarura që në bazë të qëndrueshme kryejnë të gjitha funksionet si subjekte ekonomike të pavarura.

3. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë UA korrespondojnë me përkufizimet e përdorura në Ligj.

Neni 4

Detyrimi për paraqitjen e kërkesës

1. Pjesëmarrësit në përqendrim janë të detyruara të dorëzojnë në Autoritet kërkesën për qëllimin e realizimit të përqendrimit në tekstin e mëtejshëm: (Kërkesa), nëse plotësohen kushtet e parapara në nenin 13 të Ligjit.

2. Detyrimin e paraqitjes së kërkesës pranë Autoritetit e kanë:

2.1. Të gjitha njësitë bashkuese do të paraqesin kërkesën së bashku në rastet e bashkimit të dy a më shumë ndërmarrjeve të pavarura ose pjesëve të këtyre ndërmarrjeve;

2.2. Të gjitha njësitë që fitojnë kontrollin do të paraqesin kërkesën së bashku në rastet e fitimit të kontrollit të përbashkët të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë të tërësisë, apo të një pjese të një apo më shumë ndërmarrjeve tjera.

2.3. Njësia ekonomike që merr kontrollin në rastet e fitimit të një kontrolli të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë të të gjithë ose një pjese të një, ose më shumë ndërmarrjeve të tjera.

2.4. Subjekti ofertues në rastet e një oferte publike për të blerë një ndërmarrje.

3. Nëse njoftimi në emër të ndërmarrjes paraqitet nga një përfaqësues, ky i fundit do të paraqesë një autorizim të lëshuar në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj, duke i konfirmuar të drejtat e përfaqësuesit për të vepruar në emër të ndërmarrjes së përfaqësuar.

4. Nëse njoftimi paraqitet bashkërisht nga disa ndërmarrje, ndërmarrjet do të kenë një përfaqësues të përbashkët të autorizuar, të paktën për të transmetuar dhe marrë dokumentet në emër të të gjitha ndërmarrjeve.

5. Në rastet kur njoftimi paraqitet për disa ndërmarrje bashkërisht, sekretet tregtare ose informacione të tjera konfidenciale të këtyre ndërmarrjeve mund të paraqiten në zarfe të veçanta, të cilët do të shënohen si shtojca në njoftim.

6. Sipas paragrafit 5 të nenit 13 të Ligjit, nëse dy ose më shumë transaksione (ku secila prej tyre sjellë një fitim kontrolli) bëhen brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare midis të njëjtave ndërmarrje, ato do të kualifikohen si një përqendrim i vetëm që lind në data e transaksionit të fundit. Nuk ka rëndësi nëse ato transaksione lidhen ose jo me pjesë të të njëjtit biznes, ose kanë të bëjnë me të njëjtin sektor. Kjo nuk vlen atëherë kur personat ose ndërmarrjet e njëjta bashkohen me ndërmarrje të tjera vetëm për disa nga transaksionet e përfshira. Është e mjaftueshme nëse transaksionet, edhe pse nuk kryhen midis të njëjtave ndërmarrje, kryhen midis ndërmarrjeve që i përkasin të njëjtave grupe përkatëse. Dispozita zbatohet gjithashtu për 2 (dy) ose më shumë transaksione midis të njëjtave ndërmarrje nëse ato kryhen njëkohësisht. Sa herë që ato shpërndahen në fitimin e kontrollit nga e njëjta ndërmarrje, transaksione të tilla të njëkohshme midis të njëjtave palë formojnë një përqendrim të vetëm edhe nëse ato nuk janë të kushtëzuara me njëra - tjetrën.

7. Kërkesa tek Autoriteti nuk do të paraqitet nëse, pas lejitimit të Autoritetit për të ekzekutuar përqendrimin, njësitë ekonomike që merr kontrollin fiton një numër të parëndësishëm më të lartë të të drejtave të votës, aksioneve ose titujve të tjerë në krahasim me atë që ishte deklaruar në njoftimin e mëparshëm për të cilin Autoriteti dha lejen. Fitimi i të drejtave të tilla, të cilat nuk e ndryshojnë cilësinë e kontrollit të njësisë ekonomike të kontrolluar, konsiderohet të jetë e parëndësishme.

Neni 5

Përcaktimi i Pjesëmarrësve në Përqendrim

1. Në një bashkim pjesëmarrësit në përqendrim janë secila prej ndërmarrjeve që bashkohen.
2. Në rastet e fitimit të kontrollit, njësitë e mëposhtme konsiderohen si pjesëmarrëse në përqendrim:
 - 2.1 nëse fitohet kontrolli i një ndërmarrje, pjesëmarrësit në përqendrim janë ndërmarrja blerëse dhe një ndërmarrje e blerë;
 - 2.2 nëse fitohet kontrolli i përbashkët i një ndërmarrje të sapokrijuar, pjesëmarrës në përqendrim janë secila ndërmarrje që fiton kontrollin e një ndërmarrjeje të sapo krijuar. Një ndërmarrje e sapo krijuar nuk është pjesëmarrëse në përqendrim;
 - 2.3 nëse fitohet kontrolli i një pjese të një ndërmarrjeje, ose një pjese të aktiveve të saj, ku një pjesë e tillë mund të konsiderohet si një biznes me një prani në treg, ndaj të cilit mund t'i atribuohet qartë një qarkullim në treg, pjesëmarrësit në përqendrim janë ndërmarrja blerëse dhe pjesa e blerë e një ndërmarrje, ose një pjesët e pasurive të saj;
 - 2.4 nëse një ose më shumë aksionarë fitojnë kontroll, ose me anë të futjes apo zëvendësimit të një ose më shumë aksionarëve, në një situatë të kontrollit të përbashkët para dhe pas veprimit, pjesëmarrësit në përqendrim janë aksionarët (si ata ekzistues, po ashtu të rinjtë) që ushtrojnë kontrollin e përbashkët, si dhe vetë sipërmarrja e përbashkët;
 - 2.5 nëse fitimi i kontrollit ndodh përmes një ndryshimi nga kontrolli i përbashkët në kontrollin e vetëm, normalisht, një aksionar i fiton aksionet e mbajtura më parë nga

aksionarët e tjerë. Në këtë situatë, pjesëmarrësit në përqendrim janë aksionari blerës dhe sipërmarrja e përbashkët, aksionari dalës nuk është pjesëmarrës në përqendrim;

2.6. nëse fitimi i kontrollit ndodh përmes një ndryshimi nga kontrolli i vetëm në kontrollin e përbashkët, kur kontrolli i përbashkët fitohet nga aksionarë të rinj së bashku me aksionarin i cili kishte kontrollin i vetëm para përqendrimit, të gjithë pjesëmarrësit në përqendrim janë të gjithë aksionarët që fitojnë kontroll të përbashkët. Ndërmarrja e përbashkët nuk është pjesëmarrëse në përqendrim;

2.7. nëse kontrolli fitohet nga një sipërmarrje e përbashkët, e cila kryen të gjitha operacionet e saj në baza të përhershme si një njësi ekonomike e pavarur, pjesëmarrësit në përqendrim janë ndërmarrja e përbashkët dhe ndërmarrja kontrolli i së cilës fitohet;

2.8. nëse kontrolli fitohet nga një sipërmarrje e përbashkët, e cila nuk i kryen të gjitha operacionet e saj në baza të përhershme si një entitet i pavarur ekonomik, pjesëmarrësit në përqendrim janë ndërmarrjet që kontrollojnë sipërmarrjen e përbashkët dhe ndërmarrja kontrolli i së cilës është fituar.

Neni 6 Llogaritja e Qarkullimit


1. Për të vlerësuar nëse përqendrimi përkatës duhet t'i njoftohet Autoritetit, sipas Nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit, duhet të llogaritet qarkullimi vjetor i pjesëmarrësve në përqendrim.

2. Shumat që do të përfshihen në llogaritjen e qarkullimit duhet të korrespondojnë me 'aktivitetet e zakonshme' të ndërmarrjes. Ky është qarkullimi i arritur nga shitja e produkteve, ose ofrimi i shërbimeve gjatë rrjedhës normale të biznesit të tij gjatë vitit para përqendrimit. Në përgjithësi përjashtohen ato elemente që janë të shënuara nën titujt 'të hyra financiare' ose 'të hyra të jashtëzakonshme' në llogaritë e ndërmarrjes.

3. Qarkullimi i një ndërmarrje llogaritet pa tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSh) dhe taksat e tjera që lidhen drejtpërdrejt me qarkullimin.

4. Nëse pjesëmarrësi në përqendrim është një ndërmarrje që i përket një grupi ndërmarrjesh të ndërlidhura, siç është përkufizuar koncepti në nenin 3 paragrafi 11 të Ligjit, qarkullimi do të përfshijë shumën e qarkullimit të përgjithshëm të të gjitha ndërmarrjeve që i përkasin grupit të ndërmarrjeve të lidhura. Qarkullimi që rezulton nga shitja e mallrave, ose shërbimeve brenda grupit të ndërmarrjeve, nuk merret parasysh në llogaritjen e qarkullimit sipas nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit.

5. Llogaritja e qarkullimit të një ndërmarrjeje që i përket një grupi ndërmarrjesh të ndërlidhura shpjegohet në skemën e mëposhtme "Llogaritja e qarkullimit të një grupi ndërmarrjesh të lidhura".



5.1. skema tregon grupin e ndërmarrjeve të ndërlidhura të ndërmarrjes a:

- a) pjesëmarrësi në përqendrim;
- b) filialet e saj, ndërmarrjet e mbajtura bashkërisht së bashku me palët e treta (b3) dhe filialet e tyre (b1 dhe b2);
- c) ndërmarrjet mëmë dhe ndërmarrjet e tyre mëmë (c1);
- d) filialet e tjera të ndërmarrjeve mëmë të pjesëmarrësit në përqendrim;
- e) ndërmarrjet e mbajtura bashkërisht nga dy (ose më shumë) ndërmarrje të grupit;
- x) pala e tretë;

5.2. X nuk i përket grupit të ndërmarrjeve të ndërlidhura të ndërmarrjes a;

5.3. përqindjet e paraqitura në skemë lidhen me përqindjen e të drejtave të votës që mban ndërmarrja përkatëse mëmë.

6. Qarkullimi i ndërmarrjes së përbashkët ndahet në mënyrë të barabartë midis ndërmarrjeve kontrolluese, pavarësisht nga pjesa e tyre në kapital, ose e të drejtave të votës.

7. Kur kontrolli i përbashkët transferohet në kontrollin e vetëm dhe kontrolli i vetëm fitohet nga ndërmarrja që kishte kontroll të përbashkët, qarkullimi i blerësit të kontrollit llogaritet duke përfshirë të hyrat e shitësit të kontrollit dhe qarkullimi i shitësit të kontrolluarit llogaritet duke përfshirë qarkullimin e blerësit të kontrollit.

8. Nëse përqendrimi lidhet me blerjen e një pjese, ose disa pjesëve të një ose më shumë ndërmarrjeve, pavarësisht nëse ato janë themeluar si persona juridikë, për qëllimet e nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit, vetëm qarkullimi që lidhet me pjesët që janë subjekti i përqendrimit do të merret parasysh në lidhje me shitësin, ose shitësit.

Neni 7

Barra e provës

Paraqitësi i kërkesës është i detyruar t'i kompletjë dhe t'ia paraqesë Autoritetit të gjitha të dhënat, dokumentet dhe provat e nevojshme për të vlerësuar lejin e përqendrimit të kërkuar në kuptim të dispozitave të Ligjit dhe të këtij UA.

Neni 8

Afati për Paraqitjen e Kërkesës

1. Kërkesa duhet t'i paraqitet Autoritetit për vlerësim me lidhjen e një kontrate që fiton kontrollin mbi një ndërmarrje, ose një pjesë të një sipërmarrjeje pas publikimit dhe para ekzekutimit të përqendrimit.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, pjesëmarrësit në përqendrim mund të paraqesin kërkesën para nënshkrimit të kontratës dhe para bërjes së përqendrimit publik, respektivisht nëse ata i vërtetojnë pritjet reale se marrëveshja për kontratën ose bërja publike e përqendrimit do të bëhen.

3. Kërkesa mund t'i paraqitet Autoritetit gjatë ditëve të punës dhe orarit të punës, ose të dërgohet me postë. Nëse njoftimi i paraqitet Autoritetit në një ditë jo pune, ose pas orarit të punës, data e marrjes së tij do të regjistrohet në Autoritet në ditën tjetër të punës që vijon.

Neni 9

Format dhe metodat për Plotësimin e Kërkesës

1. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim. Kjo kërkesë i dorëzohet Autoritetit në formë fizike dhe elektronike.

2. Për parashtrimin e kërkesës nuk ka rregulla të një forme të veçantë.

3. Kërkesa duhet të paraqitet në letër të formatit A4.

4. Paraqitësi i kërkesës duhet të plotësojë formularin/kërkesën, me llojin e shkronjave Book Antiqua, madhësia 12, si vijon:

- 4.1. të gjitha të dhënat e parapara në nenin 11 respektivisht në nenin 12 të këtij UA, duhet të shkruhen në listë të veçantë, me mundësinë që në rast nevojë të shtojë po aq fletë sa të jenë të nevojshme që e dhëna të jetë sa më e plotë;
- 4.2. numri rendor dhe emri e saktë i çdo të dhëne, sipas renditjes së përcaktuar në nenin 11, respektivisht në nenin 12 të këtij UA shkruhet në mënyrë të dukshme, në fillim të listës;
- 4.3. nën numrin dhe emrin e të dhënave, të shkruara në mënyrën e përshkruar në paragrafin 4 nënparagrafi 4.2 të këtij neni:
 - 4.3.1. shkruhen të dhënat dhe ofrohet një përshkrim i detajuar dhe i plotë i rrethanave në lidhje me përqendrimin,
 - 4.3.2. shkruhen të dhënat që nuk janë relevante për procedurën e vlerësimit të përqendrimit të paraqitur dhe ceken arsyet për këtë,
 - 4.3.3. në rastet e cekura në nenin 17 paragrafi 2 të këtij UA të theksojë se nga kush dhe kur është përpjekur për të marrë informacion, arsyet pse nuk ka mundur t'i mbledhë të dhënat dhe ku duhet Autoriteti të mbledhë informacionet që mungojnë;
- 4.4. pas tekstit që i referohet ndonjë informacioni paraqiten dokumente, dëshmi, analiza, diagrame ose dokumente tjera që vërtetojnë të dhënat nga ndonjë pikë e veçantë, dhe paraqiten në kërkesën e bashkangjitur.
- 4.5. sipas nevojës paraqet edhe të dhëna tjera dhe përshkrime që konsideron se mund t'i ndihmojë Autoritetit në procedurën e vlerësimit;
- 4.6. në fund të kërkesës në një listë të veçantë në mënyrë të qartë shkruan “Kërkesës i bashkëngjiten”, nën të cilën i shënon të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e shkruara, analizat dhe diagramet, të cilat i parashtron me kërkesë.

Neni 10 **Gjuha e Kërkesës**

Kërkesa, njoftimet dhe të gjitha dokumentet që dorëzohen me kërkesë, paraqiten në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Nëse njoftimi origjinal, kërkesa apo dokumentet që paraqiten me njoftimin janë në një gjuhë të huaj, paraqitësi i kërkesës është i detyruar që bashkë me origjinalin të dorëzojë dhe një kopje të vërtetuar të origjinalit, të përkthyer dhe vërtetuar në njërën nga gjuhët zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Numri i Kopjeve

1. Kërkesa dhe të gjitha shtojcat në kërkesë duhet të dorëzohen në një kopje.
2. Përjashtimisht, në disa raste, Autoriteti mund të kërkojë që përveç kërkesës dhe shtojcave tjera origjinale të dorëzohen edhe një ose më shumë kopje të kërkesës dhe shtojcave tjera, të cilat nuk kanë nevojë për t'u vërtetuar.

Neni 12

Vërtetësia dhe plotësia e informacionit

Të dhënat e cekura në kërkesë duhet të jenë të sakta dhe të plota.

Neni 13

Shenja e të dhënave konfidenciale

1. Duke pasur parasysh se vendimi i Autoritetit mbi vlerësimin e lejimit të përqendrimeve publikohet, paraqitësi i kërkesës është i detyruar që çdo të dhënë, qartë dhe dukshëm të shënojë se a është fjala për të dhënat që aplikohet dispozita e fshehtësisë zyrtare dhe afariste nga neni 51 paragrafi 2 të Ligjit. E njëjta gjë vlen edhe për provat e bashkangjitura dhe dokumentet që paraqitësi i kërkesës ose ndërmarrësit tjerë ia parashtrojnë Autoritetit.
2. Do të konsiderohet se mund të publikohen të gjitha të dhënat që në raport nuk janë shënuar në mënyrën e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe të gjitha të dhënat që janë shënuar si sekrete siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, për të cilat Autoriteti ka gjetur se janë të publikuara ose të njohura botërisht.

Neni 14

Përmbajtja e detyrueshme në Kërkesë

1. Kërkesa për përqendrim duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1. firmën ose emrin, selinë dhe llojin e veprimtarisë të paraqitësit të kërkesës;
 - 1.2. firmën ose emrin, selinë dhe llojin e veprimtarisë të të gjithë pjesëmarrësve në përqendrim;
 - 1.3. emrin dhe autorizimin e agjentit, ose përfaqësuesit, i cili dorëzon njoftimin si përfaqësues i paraqitësit të kërkesës;
 - 1.4. emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe e-mail adresën e personit që paraqitësi i kërkesës e ka emëruar si person përgjegjës për kontakte dhe bashkëpunim me Autoritetin, nëse ky person është i ndryshëm nga personi i cili ka dorëzuar kërkesën;

- 1.5. një përshkrim të detajuar të formës juridike të përqendrimit;
- 1.6. thirrjen në bazën ligjore të përqendrimit (emrin e dokumentit, numrin e biznesit, selinë ose emrin e palëve në punët konkrete juridike, vendin dhe datën e lidhjes së punëve juridike), siç janë:
 - 1.6.1. marrëveshja e përqendrimit,
 - 1.6.2. marrëveshja e bashkëngjitjes, ose vendimi relevant i organit të ndërmarrjes,
 - 1.6.3. marrëveshja e marrjes së aksioneve ose pjesëve (hises),
 - 1.6.4. marrëveshja e menaxhimit,
 - 1.6.5. marrëveshja e bartjes së fitimit,
 - 1.6.6. vendimin për ndryshimin e statutit, marrëveshjeve shoqërore, apo ndonjë akt tjetër me të cilin ndonjë pjesëmarrësi i jep ndikim vendimtar,
 - 1.6.7. marrëveshja për qiranë e pronës me të cilën ndonjërit nga pjesëmarrësit i jep ndikimvendimtar,
 - 1.6.8. oferta publike,
 - 1.6.9. marrëveshja për investime të përbashkëta;
- 1.7. pasqyrën themelore financiare vjetore për vitin paraprak (bilancin, të ardhurat ose humbjet, rrjedhën e parave të gatshme, ndryshimet në kapital, politikat kontabël dhe shënimet në pasqyrat financiare, informacion mbi shumën e vlerave të paguara të kompanive të sigurimit), si dhe raportet tjera në të cilat shihet qartë gjendja financiare e pjesëmarrësve të cilat dorëzohen me kërkesë;
- 1.8. të hyrat vjetore totale operative, financiare dhe të jashtëzakonshme të pjesëmarrësve në përqendrim, pas zbritjes së TVSh, si dhe taksat tjera që lidhen drejtpërdrejt me tregtinë dhe zbritjet, bazuar në nenin 16 paragrafi 1 i Ligjit, i paraqitur veçmas për secilën nga pjesëmarrësit në përqendrim:
 - 1.8.1. Në tregun ndërkombëtarë,
 - 1.8.2. Në tregun e brendshëm të Kosovës;
- 1.9. përcaktimin e tregjeve relevante në të cilat veprojnë pjesëmarrësit në përqendrim dhe ndërmarrjet nën kontrollin e tyre, ose ndërmarrjet që kontrollojnë ato dhe vlerësimin e aksioneve të tyre në treg para dhe pas zbatimit të përqendrimit;
- 1.10. regjistrimin dhe vlerësimin e pjesëve të tregut, fitimit, të konkurrentëve kryesorë

të pjesëmarrësve të përqendrimit në tregun relevant;

1.11. strukturën e mbajtësit të aksioneve, ose pjesëve të ndërmarrjes, i cili fiton kontroll ose ndikim dominues, para dhe pas zbatimit të përqendrimit (e shprehur në përqindje);

1.12. detaje të ndërmarrjeve tjera në tregun relevant në të cilin pjesëmarrësit në përqendrim individualisht, apo së bashku kanë dhjetë për qind (10%) ose më shumë të pjesëve të kapitalit ose dhjetë për qind (10%), ose më shumë vota, me një përshkrim të shkurtër të aktiviteteve dominuese të ndërmarrjeve;

1.13. detajet e të gjitha ndërmarrjeve në tregun relevant në të cilat anëtarët e bordit drejtues ose anëtarët e këshillit mbikëqyrës të pjesëmarrësve në përqendrim njëkohësisht janë edhe anëtarë të bordit drejtues ose këshillit mbikëqyrës, me një përshkrim të shkurtër aktivitetet e rëndësishme të atyre ndërmarrjeve;

1.14. referenca në organet e tjera të autorizuara për të ekzaminuar përqendrimin jashtë territorit të Kosovës, të cilit i janë dorëzuar kërkesat në lidhje me të njëjtin përqendrim, ose ku synohet të paraqitet një njoftim i tillë;

1.15. përshkrimin e hollësishëm të strukturës së shpërndarjes dhe shitjes së produkteve ose shërbimeve me pakicë në tregun relevant;

1.16. përshkrimin e investimeve dhe hulumtimeve të realizuara, ose që kanë për qëllim të realizohen në zhvillimin e pjesëmarrësve në përqendrim (forma dhe lloji i investimit ose hulumtimit, rëndësia e tyre në prodhimin, furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun relevant, shuma e fondeve që janë investuar për këtë qëllim ose kanë ndërmend të investojnë);

1.17. arsyet juridike dhe ekonomike për shkaqet e përqendrimit;

1.18. përshkrimin dhe një shpjegim të detajuar të përfitimeve të pritshme që do të dalin nga zbatimi i përqendrimit nga pikëpamja e interesave të konsumatorëve, veçanërisht:

1.18.1. ulja e çmimeve të produkteve dhe/ose shërbimeve;

1.18.2. rritja e cilësisë së produkteve dhe/ose shërbimeve;

1.18.3. futja e risive (zbulimeve);

1.19. nënshkrimin e personit përgjegjës për saktësinë e të dhënave në kërkesë;

1.20. vendin dhe datën e dorëzimit.

Neni 15

Të dhëna të tjera shtesë

1. Përveç të dhënave të detyrueshme të referuara në nenin 11. të këtij UA, Autoriteti mund të kërkojë të dhëna tjera shtesë, të cilat i konsideron të nevojshme dhe e ndihmojnë në vlerësimin e përqendrimit, e në veçanti:

- 1.1. numrin e të punësuarve në ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim dhe numrin e të punësuarve në të gjitha ndërmarrjet e grupit, anëtarë të të cilit janë pjesëmarrëse në përqendrim, në vitin para përqendrimit;
- 1.2. listën e 5 (pesë) furnizuesve më të mëdhenj të secilit prej pjesëmarrësve në përqendrim, përfshirë vlerën e prokurimit në vitin para përqendrimit;
- 1.3. listën e 5 (pesë) klientëve më të mëdhenj të secilit prej pjesëmarrësve në përqendrim, duke përfshirë edhe vlerën e shitjes në vitin para përqendrimit;
- 1.4. të dhënat mbi vlerën dhe volumin e shitjeve të shprehura në euro (€), respektivisht numrin e copëve, apo të njësisive matëse që pjesëmarrësit në përqendrim kanë arritur nga shitja e produkteve, apo shërbimeve në tregun relevant në vitin para përqendrimit.

Neni 16

Kopjet e Detyrueshme bashkë me Kërkesën

1. Paraqitësi i kërkesës, së bashku me kërkesë, duhet të paraqesë dokumente dhe prova të tjera të shkruara, si në vijim:

- 1.1. certifikatën nga regjistri i gjykatës ekonomike ose ndonjë regjistri tjetër në të cilën janë të dukshme të dhënat e firmës, selia, dhe veprimtaria e paraqitësit të kërkesës;
- 1.2 certifikatën nga regjistri i gjykatës ekonomike, ose ndonjë regjistri tjetër në të cilën janë të dukshme të dhënat e firmës, selia dhe veprimtaria e të gjithë pjesëmarrësve në përqendrim;
- 1.3. autorizimin e vlefshëm në qoftë se kërkesa bëhet nga personi i autorizuar;
- 1.4. kopjen origjinale, ose fotokopje e vërtetuar të bazës juridike të përqendrimit, me përkthim të vërtetuar në gjuhën shqipe, si për shembull:
 - 1.4.1. marrëveshja e përqendrimit,
 - 1.4.2. marrëveshja e bashkëngjijtes, ose vendimi relevant i organit të ndërmarrjes,
 - 1.4.3. marrëveshja e marrjes së aksioneve, ose pjesëve,
 - 1.4.4. marrëveshja e menaxhimit,

1.4.5. marrëveshja e bartjes së fitimit,

1.4.6. vendimin për ndryshimin e statutit, marrëveshjeve shoqërore, apo ndonjë akt tjetër me të cilin ndonjë pjesëmarrësi i jep ndikim vendimtar,

1.4.7 marrëveshja për qiranë e pronës me të cilën ndonjërit nga pjesëmarrësit i jep ndikim vendimtar,

1.4.8. oferta publike,

1.4.9. marrëveshja për investime të përbashkëta;

2. Raportin themelor të financave vjetore për pjesëmarrësit në përqendrim për vitin financiar para zbatimit të përqendrimit, me të dhënat mbi të hyrat e përgjithshme të të gjitha ndërmarrjeve në përqendrim që rrjedhin nga shitja e produkteve apo shërbimeve, pas zbritjes së TVSh, taksa të tjera që lidhen drejtpërdrejt me tregtinë dhe zbritjen.

2.1. në tregun ndërkombëtar;

2.2. në tregun e brendshëm të Kosovës;

2.3. të gjitha analizat në dispozicion, studimet, prezantimet apo raportet tjera të përgatitura për çdo anëtar të bordit menaxhues, ose këshillit mbikëqyrës, ose kryetarit dhe/ose anëtarëve të kuvendit të aksionarëve, të cilët i nënshtrohen vlerësimit dhe analizës së përqendrimit nga pikë vështrimi i konkurrencës, kushtet dhe ekzistenca e konkurrentëve aktualë dhe potencialë në tregun relevant;

2.4. paraqitjen grafike (diagramin) të strukturës organizative të pjesëmarrësve në përqendrim dhe ndërmarrjet e lidhura nga e cila janë të dukshme në veçanti:

2.4.1. lidhjet në mes të pjesëmarrësve në përqendrim dhe ndërmarrjeve të lidhura;

2.4.2. pjesët të cilat shoqata dominuese i ka në kapitalin themeltar, shoqatat e varura, respektivisht degët që kanë në pjesët tjera të filialeve brenda grupit, respektivisht grupeve të mëdha (të shprehura në përqindje);

2.5. raportin administrativ, me të cilin shpjegohet ana juridike dhe ekonomike e përqendrimit;

2.6. vendimin e organeve tjera kompetente për vlerësimin e përqendrimit jashtë territorit të Republikës së Kosovës, te të cilat është paraqitur kërkesa për lejimin e përqendrimit, respektivisht dëshminë se kërkesa është parashtruar.

Neni 17
Kopjet tjera që i bashkëngjiten Kërkesës

1. Me dokumentacionin e specifikuar në nenin 13 të këtij UA, Autoriteti mund të kërkojë bashkëngjitjen e dokumenteve tjera që përmbajnë të dhëna për të cilat konsideron se do të mund të ndihmonin në vlerësimin e përqendrimit të kërkuar, në veçanti:

1.1. pasqyrën reale për pjesëmarrësit në përqendrim gjatë 3 (tri) viteve rresht që i paraprinë vitit të zbatimit të përqendrimit, me të dhënat mbi të hyrat e përgjithshme të të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim të rrjedhura nga shitja e produkteve dhe/ose shërbimeve, pas zbritjes së vlerës së shtuar, tatimeve tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejtë në qarkullim dhe zbritje:

1.1.1. në tregun ndërkombëtar,

1.1.2. në tregun e brendshëm të Kosovës;

2. Vlerën dhe volumin e prodhimit dhe/ose shitjes, të shprehura në euro, respektivisht numrin e pjesëve ose të njësisive matëse, nga pjesëmarrësit në përqendrim, të realizuara nga shitja e produkteve dhe/apo shërbimeve në tregun relevant në 3 (tri) vitet rresht, që i paraprinë vitit të zbatimit të përqendrimit.

Neni 18
Forma dhe përmbajtja e Kërkesave

1. Në rastet që parasheh neni 14, paragrafi 1 i Ligjit, bankat, kompanitë e sigurimit dhe institucionet tjera financiare janë të detyruara që Autoritetin ta njoftojnë për fitimin e aksioneve, ose pjesë në ndërmarrje tjera me ç'rast kanë ardhur nga qarkullimi normal në kuadër të veprimtarisë së rregullt të atyre institucioneve, e që përfshin transaksionet dhe letrat me vlerë për llogari të vet, ose llogari për palët e treta (në tekstin e mëtejshëm: paraqitësi i kërkesës).

2. Kërkesa duhet të dorëzohet me shkrim.

3. Në lidhje me gjuhën dhe numrin e kopjeve në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e nenit 7 dhe 8 të këtij UA, lidhur me kërkesën për përqendrim.

4. Kërkesa në veçanti duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

4.1. firmën dhe selinë e paraqitësit të kërkesës;

4.2. firmën, selinë dhe llojin e veprimtarisë, respektivisht emrin dhe adresën e personit për të cilin paraqitësi i kërkesës ka marrë (blerë) aksionet, ose pjesët;

4.3. firmën, selinë dhe llojin e veprimtarisë së ndërmarrjes nga e cila paraqitësi i kërkesës i ka fituar aksionet ose pjesët;

4.4. strukturën e aksioneve, ose strukturën e një pjese të veprimtarisë së ndërmarrjes nga e cila paraqitësi i kërkesës i ka fituar aksionet, ose pjesët e veprimtarisë;

4.5. afatin, brenda të cilit paraqitësi i kërkesës synon t'i shesë aksionet e marra, ose pjesët.

5. Së bashku me kërkesën, duhet të dorëzohen:

5.1. deklarata e paraqitësit të kërkesës se aksionet, ose pjesët e marra i mbanë përkohësisht me qëllim të rishitjes së tyre;

5.2. deklaratat e parashtruesit të kërkesës se aksionet ose pjesët e blera të veprimtarisë së ndërmarrjes nuk do të përdoren në mënyrë që të mundësojë ndonjë ndikim në sjelljen konkurruese të asaj ndërmarrje;

5.3. deklaratat e paraqitësit të kërkesës se e drejta për të ushtruar të drejtën e votës do të përdoret vetëm në përgatitje për shitjen e ndërmarrjes së cilës i janë blerë aksione ose pjesë të veprimtarisë, ose për shitjen e një pjese të ndërmarrjes (nëse shfrytëzohet e drejta e votës);

5.4. deklarata e paraqitësit të kërkesës se e drejta që fitohet nga aksionet, ose pjesët e fituara nuk do të përdoret në asnjë mënyrë që do të parandalojë, kufizojë apo çrregullojë konkurrencën në treg .

Neni 19

Llogaritja e të ardhurave të institucioneve financiare

1. Të hyrat totale të institucioneve financiare sipas Nenit 14 të Ligjit, do të përcaktohen bazuar në të hyrat e tyre totale nga aktivitetet operacionale nga viti financiar paraparak, i cili i paraprin përqendrimit.

2. Për institucionet financiare, të hyrat totale të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, do të përcaktohen pasi të zbriten taksat, të cilat lidhen drejtpërdrejt me elementet e mëposhtme:

2.1 të hyrat nga interesi;

2.2 të hyrat nga aksionet, letrat me vlerë me norma interesi të ndryshueshme, si dhe interesat e pjesëmarrjes në kapital;

2.3 të hyrat nga borxhet e arkëtueshme;

2.4 fitimi neto nga operacionet financiare;

2.5 të hyrat nga aktivitetet e tjera.

3. Për të hyrat totale të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, ato llogariten nga vlera bruto e premieeve të nënshkruara, të cilat përfshijnë të gjitha

shumat dhe borxhet e arkëtueshme të arkëtuara, bazuar në kontratat e sigurimit, të lëshuara nga kompanitë e sigurimeve, ose për llogari të tyre, përfshirë premiumet e ri-sigurimit, pas zbritjes së taksave, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me elementët e sipërpërmendur.

4. Një ndërmarrje që kryen si veprimtari kryesore lizingun financiar është një institucion financiar sipas kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni dhe të hyrat e saj llogariten sipas rregullave specifike të përcaktuara në këtë nen. Sidoqoftë, aktivitetet operationale të lizingut nuk konsiderohen se kryhen nga institucionet financiare dhe për këtë arsye, për ndërmarrjet që kryejnë këtë aktivitet zbatohen rregullat e përgjithshme të llogaritjes së të hyrave.

Neni 20

Kërkesa për vazhdimin e afatit

1. Paraqitësi i kërkesës duhet t'i dorëzojë Autoritetit kërkesën për vazhdimin e afatit të paraparë në nenin 11 paragrafi 4.1 të Ligjit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para afatit të përcaktuar në kërkesë (neni 15, paragrafi 4, nën paragrafi 4.5 të këtij UA, apo afatit të paraparë në nenin 11 paragrafi 4.1 të Ligjit).
2. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim dhe të përmbajë:
 - 2.1. arsyet pse shitja e aksioneve ose të pjesëve nuk ka mund të bëhet brenda afatit kohor;
 - 2.2. periudhën për të cilën kërkohet zgjatja e kohës në të cilën shitja do të bëhet e që nuk mund të jetë më e gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.
3. Mbi kërkesën për zgjatjen e afatit kohor, Autoriteti do të nxjerrë konkluzion të veçantë.

Neni 21

Testimi i plotësisë së njoftimit

1. Pas pranimit të njoftimit për qëllimin e përqendrimit Autoriteti konstaton se, kërkesa:
 - 1.1. është paraqitur nga personi i autorizuar;
 - 1.2. është paraqitur në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh;
 - 1.3. përmban të gjithë të dhënat e nevojshme;
 - 1.4. kopjet e njëjta me origjinalet, si dhe
 - 1.5. përkthimi i certifikuar.
2. Në rast se paraqitësi i kërkesës, për shkaqe të arsyeshme, dhe përkundër përpjekjeve, nuk ka qenë në gjendje të kompletojë ndonjë të dhënë, apo dokument të përshkruar si pjesë e detyrueshme e përmbajtjes së kërkesës, kjo duhet të evidentohet në (kërkesë), duke deklaruar:

- 2.1. nga kush dhe kur është përpjekur të mbledhë ato të dhëna,
- 2.2. arsyet përse ai nuk ka mundur t'i mbledhë ato të dhëna,
- 2.3. ku do të duhej Autoriteti të mbledhë të dhënat që mungojnë.

3. Në rastin e përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti mund të kërkojë nga paraqitësi i njoftimit që në vend të të dhënave që mungojnë me shkrim t'i paraqet analizat e saj, si dhe vlerësimin e kushteve dhe gjendjen e të dhënave që mungojnë.

4. Kërkesa me të dhënat e parashikuara në nenin 11 të këtij UA, dhe kopjet përkatëse nga neni 13 i këtij UA, do të konsiderohet kërkesë e plotë.

Neni 22

Vërtetimi për kërkesën e dorëzuar

1. Kur Autoriteti konstaton se kërkesa është e plotë, në kuptim të nenit 17 paragrafi 4 i këtij UA, do të lëshojë një vërtetim të veçantë.

2. Vërtetimi i lëshuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, përmban në veçanti:

- 2.1. numrin e lëndës, numrin e regjistrimit dhe datën e lëshimit të vërtetimit;
- 2.2. emrin (e firmës) ose emrin e paraqitësit të kërkesës respektivisht të autorizuarit;
- 2.3. emrin (e firmës) ose emrat e pjesëmarrësve në përqendrim;
- 2.4. datën e dorëzimit të kërkesës në Autoritet;
- 2.5. ditën në të cilën kërkesa është konstatuar të jetë e plotë në kuptim të nenit 17. paragrafi 4. i këtij UA,;
- 2.6. referencë për datën e dorëzimit në kuptim të nenit 18, paragrafi 3 i ligjit, që ndalon realizimin e mëtejshëm të përqendrimit nga të gjithë pjesëmarrësit në përqendrim, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar me të cilin lejohet përqendrimi, përkatësisht afatet e parapara në nenin 18 paragrafët 3 dhe 4 dhe nenin 54 paragrafi 5 të ligjit;
- 2.7. konstatimin se kërkesa konsiderohet e plotë;
- 2.8. një referencë që me datën e dorëzimit fillon rrjedha e afatit nga neni 18. paragrafi 1 të Ligjit, dhe se përqendrimi konsiderohet i lejuar nëse Autoriteti brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nuk ka marrë konkluzionin mbi fillimin e procedurës për vlerësimin e lejitimit të përqendrimit;
- 2.9. nënshkrimin e personit i cili ka shqyrtuar (pranuar) kërkesën.

Neni 23

Kriteret e vlerësimit për lejimin e përqendrimit

1. Gjatë vlerësimit për lejimin e përqendrimit, Autoriteti vlerëson nëse përqendrimi i njoftuar nuk do të pengonte ndjeshëm konkurrencën efektive në tregun relevant, veçanërisht si rezultat i krijimit, ose forcimit të një pozite dominuese,
2. Efektet e përqendrimeve midis konkurrentëve aktualë, ose të mundshëm në të njëjtin treg relevant vlerësohen duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ të Autoritetit për Vlerësimin e Përqendrimeve Horizontale.
3. Efektet e përqendrimeve midis ndërmarrjeve, të cilat janë aktive në tregje të ndryshme relevante vlerësohen duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ të Autoritetit për Vlerësimin e Përqendrimeve Jo horizontale.
4. Sipas nenit 11 paragrafi 6 të Ligjit, në një masë që krijimi i një sipërmarrje të përbashkët nga dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura që kryejnë në mënyrë të qëndrueshme të gjitha funksionet e një njësie ekonomike autonome, ka si qëllim ose efekt bashkërendimin e sjelljes konkurruese të ndërmarrjeve që mbeten të pavarura, një bashkërendim i tillë do të vlerësohet në përputhje me dispozitat e Kapitullit II të Ligjit.

Neni 24

Shpenzimet procedurale për kërkesat për lejimin e përqendrimit

1. Për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në rastet e kontrollit të përqendrimit, aplikohen tarifat e mëposhtme:
 - 1.1. Tërheqja (paraqitja) e kërkesës për lejimin e një përqendrimi (për t'u bashkuar, për të marrë kontroll dhe kur pjesë të ndërmarrjes preken nga transaksioni), të përcaktuara në nenin 15 të ligjit nga ndërmarrjet pjesëmarrëse, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej, 1.000 (një mijë) euro.
 - 1.2. Vërtetimin për lejimin e përqendrimit, sipas nenit 18.2 dhe Vendimi, sipas nenit 55.1.5 të ligjit, i dhënë/lëshuar nga Komisioni, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej, 6.000 (gjashtë mijë) euro
 - 1.3. Tarifat e referuara nga nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, duhet të paguhen në momentin paraqitjes së kërkesës, respektivisht Njoftimit nga ndërmarrjet.
2. Pagesat e parashikuara sipas këtij neni, do të bëhen në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës.
3. Të gjitha pagesat e parashikuara në këtë Udhëzim Administrativ, nuk janë të rimbursueshme.

Neni 25

Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi Administrativ mund të propozohet nga çdo anëtar i Komisionit dhe bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryetarja

Neime Binaku - Isufi
